

**ZHVILLIMI HISTORIK I DIDAKTIKËS DHE MËSIMDHËNIES SË  
HISTORISË NË KOSOVË**

**TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SHKENCËS NË DEPARTAMENTIN E HISTORISË**

**NGA**

**EGLON RAMADANI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË  
Prishtinë**

**Nëntor, 2023**

## REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS

**Mentori:** *Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi*

**Kandidati:** *Eglon Ramadani*

**Tema:** *Zhvillimi historik i didaktikës dhe mësimdhënies së historisë në Kosovë*

Punimi i diplomës me titull “Zhvillimi historik i didaktikës dhe mësimdhënies së historisë në Kosovë” trajton rëndësisë dhe rolin që luajti didaktika në zhvillimin e procesit mësimor dhe të mësimdhënies në periudha të ndryshme të historisë, gjithashtu punimi trajton edhe aspektet shkencore dhe teorike të didaktikës dhe të mësimdhënies së historisë në Kosovë. Punimi gjithsej përbëhet nga tre kapituj:

1. Në kapitullin e parë të punimit trajtohen mendimi historik didaktik dhe praktika mësimore në periudha të ndryshme të historisë duke filluar nga ajo antike dhe më pastaj mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. Në periudhën antike në praktikën mësimore karakteristike ishte mësimi përmes ushtrimeve dhe përsëritjes, por ajo ndryshon në shumë kultura, tek grekët u zhvillua mësimi përmes pyetjes, dialogut, mësimi përmes lojës dhe përvetësimit të njohurive. Tek Perandoria Romake karakteristike e të mësuarit ishte gjithpërfshirja e qytetarëve përmes mësimin retorik, ndërsa Kinezët zhvilluan metodat e mësimin përmes ritualit për të formuar sjellje etike dhe një shoqëri të bashkuar. Periudha e mesjetës karakterizohet nga mësimet fetare dhe nga roli i kishës që kishte në këtë periudhë duke u përqendruar në fragmentet nga Bibla dhe bota e përtejshme. Periudha pas mesjetës shoqërohet me përpjekjet e mëdha që mësimi dhe metodat mësimore të largohen nga mësimet e kishës dhe të orientohet drejt synimeve, zhvillimit dhe formimit të karakterit të nxënësve dhe përdorimin e njohurive të fituara. Shekulli XX shënon një nga zhvillimet më të mëdha të praktikës mësimore duke u orientuar drejt shkollimit aktiv dhe metodave të aktiviteteve shkollore që do të ndihmojnë nxënësit në zhvillimin e aftësive të tyre. Temë kyçe e këtij kapitulli është edhe objekti i studimit të didaktikës, e cila ka edhe një përkufizim gjithëpërfshirës i cili e cilëson didaktikën si shkencë dhe teori për mësimdhënie dhe të nxënësve si dhe didaktik të historisë.

2. Kapitulli i dytë trajton çështjet e rëndësishme të edukimit dhe arsimimit tek ilirët dhe arbrit, metodat didaktike që u përdorën në këtë periudhë janë pjesa kryesore e kapitullit si dhe ndikimet nga kulturat e popujve të tjerë si grekët, romakët dhe ndikimin që pati krishterimi në zhvillimin e arsimit tek populli arbëror dhe metodat didaktike që ishin karakteristik në shumë popuj që jetën e përditshme e kishin të lidhur me krishterimin. Gjithashtu në këtë kapitull përfshihet periudha nën sundimin e Perandorisë Osmane duke veçuar metodat didaktike të mësimdhënies , të nxënës dhe ndikimin që pati kjo perandori në edukimin e popullsisë shqiptare. Shekulli XIX gjithashtu shënon arritje të mëdha në fushën e mësimdhënies dhe të zhvillimit të didaktikës. Ky zhvillim pati ndikim edhe tek Perandoria Osmane e cila me anë të reformave do të zhvillonte metoda të reja për edukim dhe arsimim, këto reforma do të ndikonin drejtpërdrejt tek populli shqiptar.
3. Kapitulli i tretë trajton procesin mësimor dhe të mësimdhënies në Kosovë në shekullin XX duke analizuar të gjitha ngjarjet historike që patën ndikim në zhvillimin e mësimimit që nga Lufta e Parë Botërore duke vazhduar në periudhën ndërmjet Luftërave Botërore dhe gjithashtu analizon dhe krahason zhvillimet që u bënë në arsim gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë. Gjithashtu kapitulli trajton mësimin e lëndës së historisë ,mënyrën se si u mësua ajo në shkolla dhe si ndikoi historia në arsimimin e popullsisë shqiptare. Ngjarjet historike që ndodhën pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë janë temë kyçe e kapitullit për arsye se njëherësh shënojnë edhe periudhën me më së shumti ngjarje dhe zhvillime sidomos në fushën e arsimit e cila u shoqërua edhe me zhvillimet në mësimdhënie dhe në të nxënës, si patën ndikim këto ndryshime në arsimimin dhe zhvillimin e popullsisë poashtu edhe si u zhvillua mësimi i historisë në shkolla, dhe cili ishte qëllimi i tij në këtë periudhë.

Në fund të punimit paraqiten përfundimet që janë arritur pas hulumtimit dhe analizës të kësaj teze.